

LIGJ
Nr. 23/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9780, DATË 16.7.2007 “PËR
INSPEKTIMIN NË NDËRTIM”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin në ndërtim”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Në fund të nenit 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Masa e pezullimit të punimeve dhe e prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm mund të vlerësohen nga inspektorati përkatës, sipas nevojave të rastit, si dënim kryesor ose dënim plotësues. Ndërsa masa e vendimit për zhdëmtim është dënim plotësues.”.

Neni 3

Nenet 12 dhe 13 shfuqizohen.

Neni 4

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Ankimi administrativ dhe gjyqësor

Kundër vendimit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik të Bashkisë/Komunës/Qarkut/Kombëtar për marrjen e masave urgjente dhe dhënien e sanksioneve administrative mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin. Në rast se në bazë të vendimit përfundimtar të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë/Komunës/Qarkut/Kombëtar që ka dhënë vendimin, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7982, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani